



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 Qershor 2008, nenit 40 shkronja (h) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që:

Në mbështetje të nenit 12, 14 dhe 17 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 e datës 4 Qershor 2008, nenit 9 shkronja (h), 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, duke u bazuar në Shkresën përcjellëse 02.2383-2/26 datë 02.06.2026 të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, lidhur me rishqyrtimin e ligjshmërisë së Vendimit 15Nr.353/01-20083, në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2026 të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM
NDRYSHIMIN E TITULLARIT TË PALUAJTSHMERISË
NGA SHKOLLA BUJQËSORE NË SHKOLLËN FILLORE E MESME E ULËT
"VËLLEZËRIT FRASHËRI" NË LIPJAN

Neni 1

NDRYSHOHET emërtimi i titullarit të paluajtshmërive në njësitë kadastrale P-71409044-00846-8 në vendin e quajtur "Bezimeni" me sipërfaqe prej 19057m² e evidentuar në certifikatën e pronësisë Nr.1152/2026 në ZK-Lipjan, nga Shkolla Bujqësore në Shkollën Fillore e Mesme e Ulët "Vëllezërit Frashëri" Në Lipjan

Neni 2

Ndryshimi i titullarit ashtu siç u cek në nenin 1 të këtij Vendimi, bëhet me qëllim të ristrukturimit të shkollave të qytetit të Lipjanit dhe bartjes së pronësisë të njësisë kadastrale me sipërfaqen e lartëcekur nga Shkolla Bujqësore në Shkollën Fillore e Mesme e Ulët "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan, si pjesë e interesit publik.

Neni 3

Me këtë Vendim obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme në lidhje me procedurën e regjistrimit nga Shkolla Bujqësore në Shkollën Fillore e Mesme e Ulët "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan, siç përcaktohet në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Zyra e Kryetarit-Sektorit pronëso-ro-juridik, Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në web-faqen elektronike të Komunës.

A r s y e t i m

Drejtoria Komunale e Arsimit-Lipjan me datë 14.04.2026 ka parashtruar kërkesën INr-462/01-17070 pran Zyrës së Kryetarit-Sektorit pronëso-ro-juridik, përmes së cilës ka kërkuar hartimin e Propozim-Vendimit për Kuvendin Komunal-Lipjan, duke marr për bazë konsideraten e sistemimit të shkollave në qytetin e Lipjanit, përkatësisht ndryshimin e titullarit për bartjen e pronësisë me sipërfaqe prej 19057m² nga njësia kadastrale P-71409044-00846-8 në vendin e quajtur "Bezimeni" e evidentuar në Certifikatën Nr.1152/2026 në ZK-Lipjan, P.SH Shkolla Bujqësore në Lipjan për Shkollën Fillore e Mesme e Ulët "Vëllezërit Frashëri" Në Lipjan, pjesë e interesit publik për ristrukturimin e shkollave në fushën e edukimit arsimor të drejtimit të caktuar.

Duke u bazuar në informacionin urban 8Nr.351/01-19709 datë 04.05.2026 nga Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrotje të Mjedisit, njësia kadastrale e lartëcekura është e destinuar si Shërbim Arsimor përkatësisht Shërbime Komuniteti, sipas Hartes Zonale të Komunës konform Vendimit të Kuvendit Komunal 15Nr.30033 datë 03.06.2021.

Ky Propozim-Vendim është miratuar paraprakisht në Kuvendin e Komunës, mirëpo me Shkresën përcjellëse 02.2383-2/26 datë 02.06.2026 të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, është kërkuar rishqyrtimi i ligjshmërisë së aktit të lartëcekur duke kërkuar që i njëjti të jetë i bazuar në dokumentet e planifikimit hapësinor të Komunës.

Përkitazi me këtë, paraprakisht kemi rishqyrtuar Vendimin për ndryshim të titullarit nga Shkolla Bujqësore në Shkollën e Mesme Gjinnazi "Ulpiana" në Lipjan, duke u bazuar në rekomandimet e MMPH-së i cili Vendim është i natyrës së njëjtë me këtë Propozim-Vendim, ku gjatë konsultimeve me ta përmes zyres ligjore të Komunës, na është rekomanduar që të veprojmë njëjtë.

Prandaj duke u bazuar në dispozitat ligjore, me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira për arsim dhe edukim më të avancuar dhe interesit publik, konform edhe rekomandimeve të MMPH-së kërkojmë nga Kuvendi Komunal miratimin e këtij Propozim-Vendimi

Shtojcë:

- Certifikata e pronësisë Nr.1152/2026 datë 07.04.2026 për parcelat 00846-8 në ZK-Lipjan
- Kopja e planit për parcelat 00846-8 në ZK-Lipjan,
- Shkresa e MMPH-së, me numër të protokollit 02-2383-2/26 datë 02.06.2026,

1Nr. 01-463/06-27302

Datë: 18.06.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





Republika e Kosovës

Republica Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja /

Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71409044-00846-8

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

1152/2026

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

07.04.2026 - 10:19

Komuna / Opština / Municipality:

LIPJAN / LIPJAN / LIPJAN

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Lipjan / Lipjan / Lipjan

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

LIPJAN / LIPJAN / LIPJAN

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71409044-00846-8	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shqetore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Urban	19057	35-1995 N.FIZ. L. F. 23/13	15.06.2015	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
BEZIMENI	0		15.06.2015	



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta korisçenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno korisçenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet Klasse Quality Class	Sipërfaqja (m ²) Povërshja (m ²) Area (m ²)
5	Tokë Ndërtimore/Gradi evnisko zemljište/Construction land	Oborr/Dvoritište/Back Yard		19057

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësihtë e adresës Pojednostiti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkritimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	P.SH. SHKOLLA BUJQËSORE LIPJAN	KCID1417382	LIPJAN / LIPJAN / LYPJAN /			1/1	35-1995	15.06.2015



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : LIPJAN

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Lipjan

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71409044-00846-8	Parcelë / Parcela / Parcel	19057



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1280

Punoi/Obradio/Created: Ramadan Hoxha

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 07.04.2026

Koha/ Vreme/ Time: 10:13:19



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR	
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA	
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING	
Njësia Org Org.Jedinka Org.Unit	02
Nr. Prot. Broj Prot. Prot.No	2383-2/26
Nr. i faqeve Broj stranica No pages	-02-
Data Datum Date	02.06.2026
PRISHTINË	

Për:	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në MAPL Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Fitore Pacolli Dalipi, Ministre në MMPH Bajram Kafexholli, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPH
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor në MMPH VL 79/26 Datë: 25.05.2026
Zyrtarët përgjegjës:	1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Arta Krashiqi - Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Bashkëpunim Ndërinstitucional në Fushën e Përfaqësimeve Gjyqësore dhe Koordinim të Marrëveshjeve
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendim Nr.15-353/01-20083 për caktimin e lokacionit për Shkollën Filllore të Mesme të Ulët "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan

I nderuar kryetar Ahmeti,
I nderuar kryesues Azemi

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (Qrk) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 05.05.2026 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Vendimin Nr.15-353/01-20083 për caktimin e lokacionit për Shkollën Filllore të Mesme të Ulët "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPLJAN			
PRANUAR MË: PRIMLJENO DANA:		14.04.2026	
NJËSIA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT SI KLASIFIKACIJE	NR. LËNDËS BR. PREDMETA	SHTOJCA PRILOG
01-462/01-17070			



KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPLJAN
MINICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATE/A:	14.04.2026
REFERENCË:	
PËR:	z.Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës në Lipjan- Zyra Pronësoro Juridike
NGA:	z.Rasim Hasani-Drejtor i DKA-së në Lipjan
LËNDA:	Kërkesë për bartjen e pronësisë nga P.Sh. Shkolla Bujqësore në SHFMU "Vëllëzrit Frasheri" në Lipjan (aktualisht në këtë parcelë është Gjimnazi "Ulpiana" në Lipjan)

Të nderuar

Duke marr në konsideratë risistemimin e shkollave të qytetit të Lipjanit, kërkojmë nga ju që të merren veprimet e nevojshme për procedurat e bartjes së pronësisë nga P.Sh. Shkolla Bujqësore në SHFMU "Vëllëzrit Frasheri" në Lipjan, konkretisht parcela e ndarë 00846-8 përmes procedurave të rregullta të kuvendit duhet të kalojë në pronësi të SHFMU "Vëllëzrit Frasheri" në Lipjan.

Shtojcë:

- Kopja e planit
- Fleta Poseduese

Ju faleminderit për bashkëpunim!